



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:157572

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05857354

C.nr.96/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Boban Aleksic, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestuese të paditësit P. B. nga fshati Zh., komuna e Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson juristi R. G. dhe av. A. G., kundër të paditurës Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës sipas kualifikimit shkollor-superior, jashtë seancës gjyqësore më datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë ç ë s h t j e s

I. REFUZOHET e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit P. B. nga fshati Zh., komuna e Gj., dhe me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit për kualifikim shkollor – superior, për periudhën kohorë nga 01.02.2023 e deri më datën 31.05.2024, t’ia paguaj shumën prej 2,711.28€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës për kualifikim shkollor –superior, për periudhën kohorë nga data 01.02.2023 e deri më datën 30.05.2024, shumën prej 2,711.28€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë 03.06.2024 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

Në padi ka theksuar se paditësja është i punësuar në SHFMU “Asdreni” në fshatin Llabjan, komuna e Novobërdës, në pozitën e mësimdhënesit me kualifikim superior, dhe i takon kompensimi shtesë më lartësi prej 27% të pagës neto 639.10 euro për periudhën kohore prej 16 muajsh. Paditësja nuk ka realizuar kompensimin për kualifikim për këtë periudhën kohore dhe se që nga data 06.02.2023 kur ka hyr në fuqi ligji i ri për pagat në sektorin publik, paditësja nuk i është kompensuar kjo shumë, ashtu sic parashihet me vendimin nr.01/33 të datës 29.08.2008. Me hyrjen në fuqi të ligjit të pagave në sektorin publik, janë ndaluar gjitha kompensimet , shtesat etj, por me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese me shenjen AGJ, 2316/24, në rastin numër KO79/23, i ka shpallur të pavlershme nenet 2,3 dhe 4 të nenit 41, i cili nen përjashton shtesat përveç atyre të njohura me ligj. Sipas argumenteve të lart cekura, e

drejta e kompensimit i takon sipas Vendimit të Qeverisë nr.01/33 të datës 29.08.2008, ku sipas këtij vendimi të gjithë mësimitdhënësit me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %.

Në fund gjykatës i ka propozuar që të aprovoj kërkesë padinë e paditëses si të bazuar në ligj, dhe ta obligoj të paditurën që t'i paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe atë për përpilim të padis shumen 104 euro, dhe taksën gjyqësore shumen prej 31 euro.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit pa bazë ligjore pasi që e paditura asnjëherë nuk ka paguar punëtorët për kualifikim shkollor dhe se nuk ka bazë ligjore për këtë, siq është shembulli i komunave tjera në Kosovë. E paditura konstaton se kërkesëpadia e paditësit në bazë të Mendimit të Gjykatës Supreme me nr.214/2023 të datës 09.10.2023 në nenin 1 respektivisht në arsyetimin e tij potencon se kualifikimi është i rregulluar me Vendim të Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008 ku e njëjta vlen deri më datën 06.02.2023, kur edhe është marrë Vendimi mbi Ligjin e Pagave nr.08/L-196 e cila nuk do të thotë se në praktikën gjyqësore ekzistojnë mendime të ndryshme e lidhur me kualifikimin e cila vërtetohet edhe me vendimin e kontratës kolektive. Në fund ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është i punësuar te e paditura (fakt i provuar nga Kontrata e punës me nr.të prot.03/33 të datës 06.12.2011 e lidhur në mes punëmëdhënsit dhe punëmarrëses, nuk është kontestues fakti se ii njejtë është me diplomë universitare fakt ky i provuar nga Diploma me nr.rendor 298 të datës 12.Gusht 2011, nuk është kontestuese se paga neto e tij është 541.07euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK), por kontestuese për gjykatën është zbatueshmëria e dispozitave ligjore në fuqi Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës së vitit 2008 dhe Kontratat Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021, pasi që të njëjtat janë shfuqizuar me Ligjin nr.03/L-147 për pagat e Nëpunësve Civil dhe në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 të datës 09.10.2023, kështu që sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit për Pagat për Zyrtarë Publik, kjo e fundit nuk do të shpallë të pavlefshme paragrafin 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, por në shërbim të parimit të sigurisë juridike, përkatësisht shmangies të krijimit të një zbrazëtie juridike që mund të afektojë zbatimin e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, do të lë në fuqi të njëjtin për periudhën prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë nenin e lartcekur në përputhje me parimin e sigurisë

juridike dhe qartësisë dhe parashikueshmërisë së normës, ashtu që të qartësohet shprehimisht që institucionet e pavarura kushtetuese rregullojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse të Ligjit të kontestuar, jo vetëm përmes akteve nënligjore, por edhe ligjeve të veçanta në përputhje të plotë me pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore të garantuar me Kushtetutë. Një qasje të tillë, ligjvënësi e ka ndjekur në rastin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë. Ndërsa, paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar, shpallet i pavlefshëm dhe shfuqizohet përmes këtij Aktgjykimi.

Po ashtu bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr.ref.Agj.2316/24 në rastin nr.KO79/23 të datës 23.01.2024 dhe në nenin 379 i cili parasheh: *Deri në plotësimin dhe ndryshimin e nenit të lartcekur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, (i) paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat); (ii) paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës); (iii) paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës); (iii) paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës); dhe (iv) paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar interpretohen dhe zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim. Më saktësisht, përkritazi me nëpunësit në (i) Presidencën e Republikës së Kosovës; (ii) Gjykatën Kushtetuese; (iii) Sistemin e Drejtësisë; (iv) Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktet e tyre të brendshme nuk kufizohen në përcaktimet e dispozitave të cilat janë deklaruar në kundërshtim me Kushtetutën. Megjithatë, dhe siç është theksuar në mënyrë të vazhdueshme nga Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, pavarësisht pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës i nënshtrohen detyrimit të zbatimit të ligjeve relevante përkritazi me menaxhimin e financave publike, procedurave të auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe kontrollit të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës sipas neneve 136 dhe 137 të Kushtetutës, respektivisht dhe Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. (ii) Zbritja e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nën punësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të Kontestuar.*

Bazuar në këtë pikë të aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses pasi që shtesat sipas nenit 22 par.2 pika (i) nuk janë ndaluar për institucionet si në vijim: Presidenca e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Sistemi i Drejtësisë dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ndërsa për institucionet tjera shtesat janë ndaluar deri sa të nxirret plotësim ndryshimi i Ligjit të Ri të Pagave sipas rekomandimeve të këtij aktgjykimi-respektivisht sipas pettimit të këtij aktgjykimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat si dhe Mendimit Juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, kompensimi i të ardhurave për kualifikim është i vlefshëm vetëm për periudhën deri më datën 06.02.2023.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, dhe në bazë të nenit 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Dega në Novobërdë
C.nr.96/2024, më datë 25.06.2024

Gjyqtari,
Boban Aleksic

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.